

# TREGU I PËRBASHKËT RAJONAL

Një katalizator për integrim më të thellë ekonomik rajonal dhe një hap përpara drejt Tregut të Vetëm të BE-së

## Ballkani Perëndimor Një rajon, një treg



#NjëRajonNjëTreg  
#TreguIPërbashkëtRajonal  
#SëBashkuMëTëFortë  
#CRM21\_24

#OneRegionOneMarket  
#CommonRegionalMarket  
#StrongerTogether  
#CRM21\_24

**NJË RAJON MË KONKURRUES E TËRHEQËS DHE MË AFËR TREGJEVE TË BE-SË**

## PËRFITIMET

**1** Më shumë punë dhe mundësi punësimi më të mira + më shumë zgjedhje me çmime më të ulëta!



**2** Të udhëtosh, të studiosh, të punosh dhe të bësh biznes më lehtë në rajon, pa pengesa!



**3** Një treg i integruar prej 18 milionë banorësh është më konkurrues në BE dhe në tregun global sesa 6 tregje të vogla!



**4** Mund të rrisë me 6.7% PBB-në në rajon!



## TREGU I PËRBASHKËT RAJONAL është për

Shqipërinë, Bosnjën & Hercegovinën, Kosovën\*, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.



RegionalCooperationCouncil



This project is funded by the European Union



\* Ky emërtim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GjND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



**ZONA E TREGTISË RAJONALE: lëvizje e lirë e mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve → heqja e pengesave dhe ulja e kostove në para dhe kohë për lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve në të gjithë rajonin**



Reduktimi i kohës së pritjes në kufi me 70% → #KorridorëtEGjelbra & KorsitëEGjelbra ndërmjet BP6 dhe mes BP6 & BE



Heqja e pengesave për lejet e punës për transferimet brenda kompanisë, si dhe për profesionet e zgjedhura kudo në Ballkanin Perëndimor



Krijimi i tregut rajonal të tregtisë elektronike



Lëvizje e lirë vetëm me kartat ID në të gjithë Ballkanin Perëndimor



Diplomat/certifikatat & kualifikimet profesionale të njohura në të gjithë rajonin



Heqja e tarifave bankare për pagesa dhe transferime parash mes BP6



**ZONA E INVESTIMEVE RAJONALE - promovimi i rajonit si një destinacion unik investimi**



Politika më të mira investimi bazuar në standardet e BE-së → tërheqja e të paktën 100 investimeve të reja potenciale për krijimin e zinxhirëve të qëndrueshëm rajonalë të vlerës.



**ZONA DIXHITALE RAJONALE - bashkimi me zonën dixhitale ndër-Evropiane**



Internet më të shpejtë për shumicën e familjeve në Ballkanin Perëndimor deri në 2024-ën



Reduktimi i tarifave Roaming me Bashkimin Evropian



Mbulim me rrjet 5G në qytetet industriale të BP6



**ZONA INDUSTRIALE DHE INOVATIVE RAJONALE - zhvillim i infrastrukturës industriale dhe të inovacionit për të siguruar, ndër të tjera, mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe për të lidhur furnizuesit me bizneset me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik**



Përmirësimi i infrastrukturës industriale dhe të inovacionit → mbështetje për NVM-të e rajonit dhe lehtësimi i aksesit në financë



Përfshirja e inovacioneve nga Ballkani Perëndimor në zinxhirët e furnizimit Evropianë



Mundësim i aksesit në tregjet ndërkombëtare për NVM-të



Nxjtja e turizmit - Promovimi i Ballkanit Perëndimor si një destinacion turistik rajonal



Tranzicioni nga ekonomia tradicionale industriale drejt ekonomisë së gjelbër dhe qarkulluese



Nxjtja e turizmit → Promovimi i Ballkanit Perëndimor si një destinacion turistik rajonal

*Plani Ekonomik dhe i Investimeve i Komisionit Evropian e bën të qartë se duke rritur bashkëpunimin rajonal ekonomik dhe tregtinë, Ballkani Perëndimor do të jetë më pranë Tregut të Vetëm të BE-së. Plani i Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal është një pjesë integrale e procesit të integritit të rajonit në BE.*

*Plani i Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal do të zbatohet nga vendet e Ballkanit Perëndimor deri në vitin 2024. RCC dhe CEFTA do të jenë organizatat kryesore rajonale që do të ndihmojnë Ballkanin Perëndimor ta zbatojë atë, së bashku me partnerë të tjerë rajonalë dhe ndërkombëtarë, në përputhje me fushën e tyre të veprimit.*



**TREGU I PËRBASHKËT RAJONAL bazohet në rezultatet e Planit Shumëvjeçar të Veprimit për një Zonë Ekonomike Rajonale:**



Tani paguajmë nga 86% në 96% më pak tarifa roaming në të gjithë Ballkanin Perëndimor



Tregtia e mallrave është rritur me 25% → Tregtia dhe transporti i produkteve bazë (ushqim, ilaçe, etj.) janë më të shpejta në të gjithë Ballkanin Perëndimor



Që nga korriku i 2021-shit, tarifat tona të roamingut do të jenë 0 në të gjithë Ballkanin Perëndimor



Mund të marrim dhe ofrojmë shërbime në çdo ekonomi tjetër të Ballkanit Perëndimor



Ne kemi Samitin tonë Dixhital të Ballkanit Perëndimor - më shumë mundësi për bizneset dhe njerëzit në fushën dixhitale



Investimet e Huaja Direkte janë rritur me 35% që nga viti 2016.